



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 242, Datë 21.12.2020

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “HEC ZALL XHUXHË” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E  
TREGTIMIT TË ENERJISË ELEKTRIKE.

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2 germa d) të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa e), nenit 5, pika 1 germa e) dhe nenit 13, të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, Nr. 109, datë 29.06.2016, si dhe nenit 15 të “Rregullores së Organizimit, Funkcionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 21.12.2020, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “HEC ZALL XHUXHË” sh.p.k., si dhe relacionin nr. 135/13 Prot., datë 17.12.2020, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqytjes, për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “HEC ZALL XHUXHË” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

**Konstatohet se:**

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 186, date 16.11.2020, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Hec Zall Xhuxhë” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Në vijim të kësaj vendimmarrje, me “Njoftimin për Licencim” nr. 62/36 prot., datë 17.11.2020, u krye njoftimi në median e shkruar dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin dhe Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palë të treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “HEC ZALL XHUXHË” sh.p.k.
- Me shkresën nr. 1165/1 prot., datë 26.11.2020, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar
- Në përgjigje të sa më sipër, shoqëria “HEC ZALL XHUXHË” sh.p.k me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1165/2, datë 03.12.2020, ka përcjellë dokumentacionin e munguar.
- Dokumentacioni i ketij aplikimi është kryesisht i plotësuar, dhe më poshtë veçohet dokumentacioni që mbetet i pa plotësuar:
  - Neni 9, pika 3, germa a) (vërtetimi për shlyerjen e tatim – taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore). Shoqëria nuk ka depozituar vërtetimet përkatëse, por në vijim vlerësohet të vendoset si kusht depozitimi i tij në ERE;
  - Neni 9, pika 3, germa c) (dokumenta që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financim dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera, etj). Shoqëria nuk ka dokumentuar aftësinë ose mbështetjen financiare në lidhje

- me veprimtarinë e tregtimit të energjise elektrike, si e tille vleresohet që kjo kërkesë të vendoset si kusht në këtë vendim.
- Neni 9, pika 4.8, germa a) (sasia e energjisë elektrike e parashikuar për tu tregtuar në GWh / sipas viteve); Shoqëria nuk ka paraqitur sa kërkohet nga kjo pikë e Rregullores dhe vlerësohet të vendoset si kusht në këtë vendim.
  - Neni 9, pika 4.8, germa “b” (kapitali financiar i parashikuar për ushtrimin e këtij aktiviteti); Shoqëria nuk ka paraqitur dokumenta në lidhje me këtë kërkesë të Rregullores dhe vlerësohet të vendoset si kusht depozitimi i dokumentacionit në ERE.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për tu pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, sipas *“Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Liçensave në Sektorin e Energjisë Elektrike”*.

Për gjithë sa më sipër cituar bordi i ERE-s,

### **Vendosi:**

1. Të licencojë shoqërinë “HEC ZALL XHUXHË” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar, me kushtin që shoqëria të depozitojë brenda 3 muajve nga marrja e këtij vendimi:
  - i. Vërtetimin për shlyerjen e tatim – taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore.
  - ii. Dokumenta që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera, etj).
  - iii. Sasinë e energjisë elektrike të parashikuar për tu tregtuar në GWh / për pesë vitet e licencës së tregtimit të energjisë elektrike.
  - iv. Kapitalin financiar të parashikuar për ushtrimin e veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike.
2. Mos plotësimi i kushteve të këtij vendimi përbën shkak për rishikimin e tij.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**  
**Petrit AHMETI**